27350

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**Nr.__27350___ Vendimi**

# VENDIM
# PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot ne date_8._/03/2002 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare Tirane **Majlinda Dogga** mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi **Veledin Brahimi** per regjistrimin si person juridik te shoqerise "**BASHKIMI**" sh.p.k.

## KONSTATOVA

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi z. **Veledin Brahimi**, per regjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare "**BASHKIMI**" sh.p.k. me dy ortake, z **Veledin Brahimi dhe znj. Miranda Sinaj,** me administrator z **Veledin Brahimi** me kapital fillestar 100.000 leke, me kuota **50% z. Veledin Brahimi** dhe **50% znj. Miranda Sinaj** me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Tirane, Rr."Barrikadave", me objekt te veprimtarise ne fushen e:

Import-eksport, tregetimin e artikujve te ndryshem te gjitha llojeve, tregetimit me shumice e pakice te mallrave te ndyshme elektro-shtepiake, ushqimore, industriale, pije, konfeksione, fruta-perime, materiale ndertimi, prodhime bujqesore e blegtorale,orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike dhe elektronike, hidro-sanitare, hidraulike, kinkaleri, kanceleri zyre e shkolle.Tregetim bimesh medicinale, eterovajore, pleherash e prodhimesh kimike, prodhimesh kozmetike dhe estetike, tregetim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi pjese kembimi per auto, bateri, goma, tregetim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venjen e tyre ne shfrytezim, tregetim pllakash, plehrash e prodhimesh kimike. Ne fushen e turizmit hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative, punime druri, tregetime prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare dhe auto-servis makinash. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda e jashte vendit
Eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 dhe te Ligjit Nr. 7638, date19.11.1992

**V E N D O S A**

Regjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare "**BASHKIMI**" sh.p.k., me dy ortake, z **Veledin Brahimi dhe znj. Miranda Sinaj,** me administrator z **Veledin Brahimi,** me kapital fillestar 100.000 leke, me kuota **50% z. Veledin Brahimi** dhe **50% znj. Miranda Sinaj** me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Tirane, Rr."Barrikadave", me objekt te veprimtarise ne fushen e:

Import-eksport, tregetimin e artikujve te ndryshem te gjitha llojeve, tregetimit me shumice e pakice te mallrave te ndyshme elektro-shtepiake, ushqimore, industriale, pije, konfeksione, fruta-perime, materiale ndertimi, prodhime bujqesore e blegtorale,orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike dhe elektronike, hidro-sanitare, hidraulike, kinkaleri, kanceleri zyre e shkolle.Tregetim bimesh medicinale, eterovajore, pleherash e prodhimesh kimike, prodhimesh kozmetike dhe estetike, tregetim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi pjese kembimi per auto, bateri, goma, tregetim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venjen e tyre ne shfrytezim, tregetim pllakash, plehrash e prodhimesh kimike. Ne fushen e turizmit hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative, punime druri, tregetime prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare dhe auto-servis makinash. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda e jashte vendit
Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligj

**GJYQTARE**
**/ Majlinda Dogga /**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
**Nr. 27350/1 Vendimit**

**V E N D I M**
**I GJYQTARES SE VETME**

Sot me date 14/02/2007, une gjyqtare Regleta Panajoti e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.1 te asamblese se Ortakeve te shoqerise "**BASHKIMI**" shpk dt.29.01.2007 dhe :

**K O N S T A T O V A**

Me vendimin nr. 27350 date 08.03.2002 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare " **BASHKIMI** " sh.p.k. me kapital fillestar 100.000 leke i ndare ne 50% Veledin Brahimi dhe 50% Miranda Sinaj me kohezgjatja mbi 10 vjet , me seli ne Tirane.
Me vendimin nr.1 te asamblese se ortakeve te shoqerise dt.29.01.2007 eshte vendosur:
-Miratimin ne parim te shitjes se kuotave ne masen 50% qe Z.Veledin Brahimi zoteron ne shoqeri dhe blerjen e tyre nga Z.Vullnet Sinaj me vleften 50.000 lek.
-Me kete shitje Z.Veledin Brahimi nuk do te zoteroj me asnje kuote ne shoqerine "**BASHKIMI**" shpk.
Me vendimin nr.2 dt.30.01.2007 te asamblese se ortakeve te shoqerise eshte vendosur:
-Miratimin e doreheqjes se Z.Veledin Brahimi nga detyra e administratorit te shoqerise dhe emerimin ne detyren e administratores Znj.Miranda Sinaj.
-Shitja e kuotave u realizua nepermjet kontrates se shitjes me nr.422 rep dhe 147 kol dt.29.01.2007 para noterit Julian Zhelegu.
-Depozitimin prane regjistrit tregtar te ketij vendimi.
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar".

**V E N D O S A**

-Pranimin e kerkeses.
-Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr.1 dt.29.01.2007 dhe te vendimit nr.2 dt.30.01.2007 te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare" **BASHKIMI** " sh.p.k si dhe kontrates se shitjes se kuotave me nr.422 rep dhe 147 kol dt.29.01.2007 para noterit Julian Zhelegu.
- Urdherohet Zyra e Rregjistrit Tregtar te njoftoj personat financiar te interesuar.
-Te behen shenimet perkatese ne rregjistrin tregtar ne kollonat 4 dhe 5.
-Kunder vendimit lejohet ankim.

**G J Y Q T A R E**

**Regleta PANAJOTI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
REGJISTRI I SHOQËRIVE TREGTARE

# URDHËR REGJISTRIMI

| | |
|---|---|
| **Kolona I** | Numri i Regjistrit Tregtar: 27350 |
| **Kolona II** | A. Emri i Shoqërisë: Brahimi, Sh.p.k<br>B. Selia: Rr. Barrikadave, Tiranë<br>C. Objekti: Tregtimi me shumicë e pakicë, import-eksport i mallrave të ndryshme industriale ushqimore etj<br>D. Kapitali: 100.000 lekë depozituar me vertetim Nr. 45 Rep. dt. 05-03-2002 Noter Nezir Shehati |
| **Kolona III** | A. Ortakët: Veledin Brahimi 50%<br>Mirande [illegible] 50%<br><br>B. Administratorët: Veledin Brahimi |
| **Kolona IV** | Kohëzgjatja: Afat 10 vjet |
| **Kolona V** | Shënime mbi aktet e shoqërisë:<br>A. Data e Nënshkrimit: 05-03-2002<br>B. Data e regjistrimit: 8-3-2002<br>C. Statuti fletë: 8 fletë<br>D. Akti i Themelimit fletë: 4 fletë |

*Shënime:* ______

GJYQTARE
[signature]

# AKT THEMELUES
# KONTRATE
# I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "BASHKIMI" sh.p.k.

Te nenshkruarit:
1- **Veledin Brahimi** I biri I Adilit dhe I Sherifes, datl.1972, lindur e banues ne Vlore, Rr."10 Korriku", Nr.140.
2- **Miranda Sinaj**, e bija e Lavdoshit, datl.1970, banuese ne Tirane, Rr."Naim Frasheri", Pall.47/1, Shk.2, Ap.49.
Mbeshtetur ne nenin 251, shkronja"c",te Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991" Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit", krijojme shoqerine tregetare private me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "**BASHKIMI**" dhe lidhim kontraten si vijon:

## FORMIMI

**NENI 1**

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur "**BASHKIMI** " sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

## VEND-QENDRIMI I SHOQERISE

**NENI 2**

Vend-qendrimi I shoqerise tregetare private "**BASHKIMI** " sh.p.k. do te jete ne Tirane, Rr."Barrikadave". Shoqeria do te hap dhe vend-qendrime te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente dhe jashte vendit.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

**NENI 3**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:

Import-eksport, tregetimin e artikujve te ndryshem te gjitha llojeve, tregetimit me shumice e pakice te mallrave te ndyshme elektro-shtepiake, ushqimore, industriale, pije, konfeksione, fruta-perime, materiale ndertimi, prodhime bujqesore e blegtorale,orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike dhe elektronike, hidro-sanitare, hidraulike, kinkaleri, kanceleri zyre e shkolle.Tregetim bimesh medicinale, eterovajore, pleherash e prodhimesh kimike, prodhimesh kozmetike dhe estetike, tregetim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi pjese kembimi per auto, bateri, goma, tregetim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venjen e tyre ne shfrytezim, tregetim pllakash, plehrash e prodhimesh kimike. Ne fushen e turizmit hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative, punime druri, tregetime prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare dhe auto-servis makinash. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda e jashte vendit

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhimi, perpunimi, sherbimi tregetimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar dhe mbi 10 vjet.
Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

## KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali I shoqerise tregetare private "**BASHKIMI** " sh.p.k.do jete 100.000 leke, dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise, si vijon:
**Veledin Brahimi.............................................50%**
**Miranda Sinaj........................................50%**

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuotat e pjesmarresve ne kapital jane te

gjitha te emeruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresisht I shlyeshem dhe I nenshkrueshem.

**NENI 7**

Ortaket duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruajne sekretin e saj dhe te mos demtojne interesat e personave te tjere dhe te shoqerise

## DREJTIMI I SHOQERISE

**NENI 8**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori I saj caktuar nga ortaket themelues te shoqerise z. **Veledin Brahimi.** Administratori ka te drejte te administroje pasurine e shoqerise dhe te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise. Ortaket e shoqerise kane te drejta e detryrime te barabarta ndaj shoqerise e ligjeve.

**NENI 9**

Te ardhuart neto te shoqerise I takojne ortakeve themelues te shoqerise, ne proporcion me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar.

**NENI 10**

Ortaket emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise.Ata kane te drejte te caktojne financier, likuidator per problemet e shoqerise, si dhe te pajtojne persona te tjere si ortatake Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare te tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

**NENI 11**

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

**NENI 12**

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme, me tekstin per rrethin e saj.

**NENI 13**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqerive tregetare" .

**NENI 14**

Ky akt themelimi (kontrate) do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente

**NENI 15**

Akti I themelimit,(kontrata) u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje do te mbetet dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private "**BASHKIMI** " sh.p.k

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

**ORTAKET THEMELUES I SHOQERISE**
**"BASHKIMI " sh.p.k**

**Veledin BRAHIMI** | **Miranda SINAJ**

# STATUT
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BASHKIMI "
# sh.p.k.

Ne baze te Ligjit 7512 date 10.08.1991"Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit"dhe te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", me vullnetin tone te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues (kontrates) ortaket:

1- **Veledin Brahimi** I biri I Adilit dhe I Sherifes, datl.1972, lindur e banues ne Vlore, Rr."10 Korriku", Nr.140.

2- **Miranda Sinaj**, e bija e Lavdoshit, datl.1970, banuese ne Tirane, Rr."Naim Frasheri", Pall.47/1, Shk.2, Ap.49.

Hartojne statutin e shoqerise si me poshte:

## EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

**NENI 1**

Shoqeria emertohet "**BASHKIMI** "sh.p.k.

**NENI 2**

Selia e shoqerise tregetare private "**BASHKIMI**" sh.p.k. do te jete ne Tirane, Rr."Barrikadave".

**NENI 3**

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti I regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se rrethit Tirane.

**NENI 4**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:

Import-eksport, tregetimin e artikujve te ndryshem te gjitha llojeve, tregetimit me shumice e pakice te mallrave te ndyshme elektro-shtepiake, ushqimore, industriale, pije, konfeksione, fruta-perime, materiale ndertimi, prodhime bujqesore e blegtorale,orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike

dhe elektronike, hidro-sanitare, hidraulike, kinkaleri, kanceleri zyre e shkolle.Tregetim bimesh medicinale, eterovajore, pleherash e prodhimesh kimike, prodhimesh kozmetike dhe estetike, tregetim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi pjese kembimi per auto, bateri, goma, tregetim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venjen e tyre ne shfrytezim, tregetim pllakash, plehrash e prodhimesh kimike. Ne fushen e turizmit hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative, punime druri, tregetime prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare dhe auto-servis makinash. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda e jashte vendit

## KAPITALI I SHOQERISE

**NENI 5**

Kapitali I shoqerise tregetare private "**BASHKIMI** " sh.p.k.do jete 100.000 leke, dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise.

Kuotat e ortakeve te shoqerise ne kapitalin fillestar jane ne proprcion si vijon:

**Veledin Brahimi..........................................50%**
**Miranda Sinaj..........................................50%**

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuotat e pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresisht I shlyeshem dhe I nenshkrueshem.Çdo kuote I takon e drejta e nje vote.

**NENI 6**

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij, teresisht apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejta ortaku duhet ta ushtroje brenda 30 diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos-ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortaku qe do te shese kuaotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te ofruara ortakut tjeter te shoqerise.

**NENI 7**

Kapitali I shoqerise perbehet nga kapitali fillestarm, mjetet e xhiros, pasuri te luajteshme e ose te paluajteshme etj te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

**NENI 8**

Kuotat e kapitalit fillestar jane dredhur nga ortaket themelues ne Banke, ne llogarine bankare te shoqerise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

**NENI 9**

Heqja dore e ortakut nga bashkepunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton dhe te drejtat qe jane krijuar para largimit te tij.

**NENI 10**

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve, ne proporcion me perqindjen e kapitalit te investuar, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali I investuar nga ortaket nuk mund te kaloje kuotat e percaktuara ne kapitalin fillestar. Rritja e kapitalit nga ortaket do te behet vetem me vendim unanim te Asamblese se ortakeve.

**NENI 11**

Shoqeria tregetare "**BASHKIMI**" sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria tregetare "**BASHKIMI**" sh.p.k. gezon te drejta sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose I huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

**NENI 12**

Shoqeria tregetare "**BASHKIMI** " vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejtat e detyrimet vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket kane patur para se ajo te krijohet.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

**NENI 13**

Organet drejtuese te shoqerise jane:
Asamblea e ortakeve.
Administratoret.
Komisioni I revizionimit.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohet ne statut. Asamblea e shoqerise perbehet nga 2 ortaket themelues.

Themeluesit e shoqerise e qeverisin ate duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te prones private te investuar ne kete shoqeri.

Vendimet qe merr Asambleja jane te detyrueshme per ortaket e shoqerise. Asambleja thirret sa here e shohin te arsyeshme ortaket themelues te shoqerise, por detyrimisht ne Dhjetor per te miratuar programin e veprimtarise per vitin e ardheshem dhe ne Mars per te miratuar bilancin kontabel te vitit te meparshem.

**NENI 14**

Shoqeria do te drejtohet nga administratoret i saj, caktuar nga ortaket themelues te shoqerise, z. **Veledin Brahimi.**

**NENI 15**

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme kur te jene pranuar unanimisht nga te gjithe ortaket themelues te shoqerise.

**NENI 16**

Hyjne brenda detyrave dhe kopetencave te asamblese se ortakeve si me poshte:

1. Ndryshimi I aktit te themelimit dhe I statutit te shoqerise.
2. Miratimi I buxhetit vjetor, I raporteve te administrimit, I inventareve dhe bilançit e llogarise vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi I detyrave dhe I kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi I garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi I tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi I formes se vules dalluese te shoqerise.

Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

**NENI 17**

Administratori jo ortak pervec detyrave qe I caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto detyra e te tjera:

1. Te mire-administroje pasurine e shoqerise
2. Te beje marrveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortaku themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise
4. Te pergjigjet per demet qe I sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te merrveshjes se bere me ortakun themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime pergjithçka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

**NENI 18**

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga Bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe I njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.

5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punetore te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

**NENI 19**

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.
2. Te siguroje punonjesit e saj.
3. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
4. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

## MARRDHENJET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

**NENI 20**

E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

**NENI 21**

Ne seline e shoqerise mbahet dokumantacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

**NENI 22**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

**NENI 23**

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

**NENI 24**

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqeria, pasi ben zbritjen e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrije masen 10% te kapitalit themeltar.

**NENI 25**

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, I mbesin ne perdorim ortakeve te shoqerise.

Fitimi I realizuar nga shoqeria do te ndahet ne mes te ortakeve te saj ne perputhje me kapitalet e investuara por pa kaluar perqindjet e percaktuara ne kapitalin fillestar. Ndarja e divideteve behet sipas menyres dhe ne afatet qe vendos asambleja e shoqerise.

Konvertimi I parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e shtetit Shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi I saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

## DISPOZITA TE VECANTA

**NENI 26**

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

## SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

**NENI 27**

Shnderrimi I shoqerise "**BASHKIMI**" sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te asamblese se ortakeve.

**NENI 28**

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne cdo kohe dhe per çfar do shkaku si :

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese te ortakeve

Ne keto raste, pronari I shoqerise vendos mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke ju percaktuar dhe detyrat Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise perderi sa ajo t'u dorezohet personave perkates fizike e juridike, duke u likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel, rezultojene te pa mjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe I takojne atij

## DISPOZITA TE PERGJITHESHME

**NENI 29**

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaku themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.

**NENI 30**

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private "**BASHKIMI**" sh.p.k.

**ORTAKET THEMELUES I SHOQERISE**
**"BASHKIMI" sh.p.k.**

**Veledin BRAHIMI** — **Miranda SINAJ**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERIA E TIRANES**
**Nr. 1101 Rep**

## V E R T E T I M

Sot me date 05/03/2002 u paraqiten para meje zoterinjte e sipershenuar madhor te pa njohur personalisht prej meje, per identitetin e te cileve u njoha nga leternjoftimet perkatese , te cilet deklaruan se sa me siper eshte hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe nenshkruhet pa verjejtje ne pranine time dhe une notere e vertetoj sipas ligjit.

**NOTER**
**/Nezir Murati /**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 422 REP.
Nr. 147 KOL.

LIKUIDUA TAKSA E PULLES

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me daten 29.01.2007 (dymije e shtate), para meje noterit Julian ZHELEGU, midis paleve te meposhteme u lidh kjo kontrate shitblerje kuotash:

**SHITES: Veledin BRAHIMI**, i biri i Adilit dhe i Sherifes, i datëlindjes 23.02.1972, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Pandi Dardha", Pall.27, Shk.1, Ap.13, i identifikuar me pasaportën nr. Z1681543, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Blerta BRAHIMI**, e bija e Lavdoshit, e datelindjes 06.02.1977, lindur ne Vlore e banuese ne Tirane, e identifikuar me pasaporten nr. Z1972664, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar,

këtu e më poshtë te quajtur Shitësi,

**BLERES: Vullnet SINAJ**, i biri i Ruzhdiut dhe Lefterisë, i datelindjes 20.08.1965, lindur ne Vlorë dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Naim Frashëri", Pall.47/2, identifikuar me pasaporten Nr.Z0597572, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, këtu e më poshtë I quajtur Bleresi,

**OBJEKTI** : Transferimi nepermjet shitjes i kuotave ne masen 50(pesëdhjetë) perqind, qe Z.Veledin BRAHIMI zoteron ne shoqerine "BASHKIMI" shpk, ne mbeshtetje te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

## PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqeria "BASHKIMI " shpk, eshte regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqësor Tirane, me vendimin Nr.27350, date 08.03.2002.

Me vendimin Nr.1, date 29.01.2007, te Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve te shoqerise "BASHKIMI" shpk, eshte vendosur shitja e kuotave ne masen 50(pesëdhjetë) perqind te bleresi Z.Vullnet SINAJ.

**Shitesi**, eshte plotesisht dakord dhe i shet me vullnetin tij te lire dhe te plote bleresit, 50 (pesëdhjetë) perqind te kuotave zoteruese ne kapitalin e shoqerise "BASHKIMI" shpk.

Nga ana e vet **Bleresi,** eshte plotesisht dakord qe te bleje 50 (pesëdhjetë) perqind te kuotave te shoqerise "BASHKIMI" shpk.

**ÇMIMI I SHITJES SE KUOTAVE DHE MENYRA E PAGESES.**

Vlera e shitjes se kuotave ne masen 50 (pesëdhjete) perqind nga shitesi, do te jete e barabarte me nje vlere prej 50.000 (pesëdhjete mije) leke, vlere kjo me te cilen jane vleresuar paketa e kuotave te shitura nga ana e Shitësit, per te cilen eshte rene dakord nga Blerësi.

Pagesa ne shumen e mesiperme eshte bere jashte zyres noteriale dhe ne menyren e pageses sipas marreveshjes se rene dakord ndermjet tyre.

**MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE KUOTAVE.**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Shitesi humbet pronesine mbi 50 (pesëdhjete) perqind te kuotave ne kapitalin e shoqerise se mesiperme, duke mos patur ne te ardhmen asnje pretendim pronesie.

Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate behet pronar i 50 (pesëdhjete) perqind te kuotave ne shoqerine "BASHKIMI" shpk.

Palet deklarojne se nuk i kane njeri – tjetrit asnje pretendim apo detyrim financiar te palikujduar te lindur si rezultat i pozicionit te tyre te meparshem si zoterues aksionesh (fitim vjetor etj.) ne shoqerine "Bashkimi " shpk.

Keshtu, me perfundimin e ketij transaksioni shitje, do te kemi kete gjendje te zoterimit te kuotave ne shoqerine " BASHKIMI" shpk :

1. Z.Vullnet SINAJ do të zotërojë 50 (pesëdhjetë) perqind te kuotave te shoqerise "BASHKIMI" shpk qe perfaqesojne 50.000 (pesëdhjetë mije) leke per kontributin ne para;

Znj.Miranda SINAJ do te zoteroje 50(pesëdhjete) perqind te kuotave te shoqerise "BASHKIMI" shpk qe perfaqesojne 50.000(pesëdhjete mije) leke per kontributin ne para.

2.**Shitesi,** pas ketij trasaksioni nuk do te zoteroje asnje kuote ne shoqerine "BASHKIMI" shpk.

**KLAUZOLA SHTESE TE KONTRATES**

Shpenzimet noteriale, te avokatit dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.

Kontrata hartohet ne pese kopje te njejta, nga te cilat nje e mbajne palet, nje kopje depozitohet ne Zyren e Regjistrit Tregtar, nje kopje depozitohet ne aktet e shoqerise dhe nje kopje prane noterit ku ajo u redaktua.

Termat e kontrates, pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilet e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time.

**SHITES**

**VELEDIN BRAHIMI**

**BLERTA BRAHIMI**

**BLERES**

**VULLNET SINAJ**

**NOTERI**

**JULIAN ZHELEGU**

**SHOQERIA "BASHKIMI"shpk**

**Rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr. 27350, date 08.03.2002**

---

# VENDIM

**Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "BASHKIMI" shpk**
**Nr.1, date 29. 01. 2007**

Sot me daten 29.01.2007, ora 10.00, z.Veledin BRAHIMI dhe Znj.Miranda SINAJ, qe jane ortake themelues te shoqerise "BASHKIMI" shpk ne mbledhjen e saj te jashtezakonshme, pasi shqyrtuan rendin e dites te njoftuar me pare, lidhur me shitjen e kuotave qe Z.Veledin BRAHIMI zoteron ne shoqerine " BASHKIMI" shpk,

**V E N D O S E N :**

1.Miratimin ne parim te shitjes se kuotave ne masen 50(pesedhjete) perqind qe Z.Veledin BRAHIMI zoteron ne shoqerine "BASHKIMI" shpk dhe blerjen e tyre nga Z.Vullnet SINAJ me vleften 50.000 (pesedhjetemije) Leke.

2.Me kete shitje, Z.Veledin BRAHIMI nuk do te zoteroje me asnje kuote ne shoqerine "BASHKIMI" shpk.

3. Autorizimin e Av.Agron SHEHAJ që të ndjekë të gjithë procedurën e nevojshme deri në depozitimin ne Zyrën e Regjistrit Tregtar pranë Gjykates së Rrethit Gjyqesor Tirane te kontrates se shitjes se kuotave dhe te ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME E ORTAKEVE TE SHOQERISE**

**"BASHKIMI" SHPK**

**VELEDIN BRAHIMI** **MIRANDA SINAJ**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERËVE TIRANË**
**Nr.** 421 **Rep**
**Nr.** 146 **Kol.**

PULLE TAKSE
100 LEKE
SHQIPERI

**VËRTETIM**

Në Tiranë, sot më 29.01.2007, përpara meje Noterit të Dhomës së Noterëve Tiranë Julian ZHELEGU, u paraqitën personalisht

Z. Veledin BRAHIMI, i biri i Adilit dhe i Sherifes, i datëlindjes 23.02.1972, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Pandi Dardha", Pall.27, Shk.1, Ap.13, i identifikuar me pasaportën nr.1032309, me cilësinë e ortakut të shoqërisë "BASHKIMI" sh.p.k. madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar
Znj. Miranda SINAJ, e bija e Lavdoshit dhe e Dritës, e datëlindjes 23.06.1970, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Naim Frashëri", Pall.47/2, e identifikuar me pasaportën nr.Z0597571, me cilësinë e ortakut të shoqërisë "BASHKIMI" sh.p.k. madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Personat e mësipërm deklarojnë se kanë hartuar aktin bashkëngjitur në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë si dhe nënshkrimi në këtë akt eshte bërë prej tyre personalisht.
Unë Noteri, vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

**NOTER**

**Julian ZHELEGU**

Julian Zhelegu

**SHOQERIA "BASHKIMI"shpk**

**Rregjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr. 27350, date 08.03.2002**

---

# VENDIM

**Asamblese se Ortakeve te shoqerise "BASHKIMI" shpk**
**Nr.2, date 30. 01. 2007**

Sot me daten 30.01.2007, ora 10.00, z.Vullnet Sinaj dhe Znj.Miranda SINAJ, me cilësinë e ortakëve te shoqerise "BASHKIMI" shpk me nga 50 (pesëdhjetë) përqind të kuotave në zotërim secili, ne mbledhjen asamblesë së ortakëve, pasi shqyrtuan rendin e dites te njoftuar me pare, lidhur me dorëheqjen e Z.Veledin BRAHIMI nga detyra e Admninistratorit ne shoqerine " BASHKIMI" shpk,

**V E N D O S E N :**

1.Miratimin e dorëheqjes së Z.Veledin BRAHIMI nga detyra e Administratorit të shoqërisë "BASHKIMI" shpk.

2.Emërimin në detyrën e Administratorit të Znj.Miranda SINAJ.

3.Autorizimin e Av.Agron SHEHAJ që të ndjekë të gjithë procedurën e nevojshme deri në depozitimin ne Zyrën e Regjistrit Tregtar pranë Gjykates së Rrethit Gjyqesor Tirane te ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE**

**"BASHKIMI" SHPK**

**VULLNET SINAJ** | **MIRANDA SINAJ**

Vullnet Sinaj | Miranda Sinaj

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANË**
**Nr.** 452 **Rep**
**Nr.** 160 **Kol.**

PULLË TAKSE
100 LEKE
R. SHQIPERISË

**VËRTETIM**

Në Tiranë, sot më 30.01.2007, përpara meje Noterit të Dhomës së Noterëve Tiranë Julian ZHELEGU, u paraqitën personalisht

Z. Vullnet SINAJ, i biri i Ruzhdiut dhe i Lefterisë, i datëlindjes 20.08.1965, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Naim Frashëri", Pall.47/2, i identifikuar me pasaportën nr.Z0597572, me cilësinë e ortakut të shoqërisë "BASHKIMI" sh.p.k. madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar
Znj. Miranda SINAJ, e bija e Lavdoshit dhe e Dritës, e datëlindjes 23.06.1970, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Naim Frashëri", Pall.47/2, e identifikuar me pasaportën nr.Z0597571, me cilësinë e ortakut të shoqërisë "BASHKIMI" sh.p.k. madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Personat e mësipërm deklarojnë se kanë hartuar aktin bashkëngjitur në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë si dhe nënshkrimi në këtë akt eshte bërë prej tyre personalisht.
Unë Noteri, vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

**NOTER**

**Julian ZHELEGU**

08 FEB 2007

# KËRKESË

*PER KOMPETENCE:* **GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

**KERKUES:** Miranda SINAJ e bija e Lavdoshit dhe Dritës, e datëlindjes 23.06.1970, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Naim Frashëri", Pall.47/2, e identifikuar me pasaportën nr. Z.0597571, me cilësinë e Administratorit të shoqërisë BASHKIMI SH.P.K.

**OBJEKTI:** Depozitimi në Regjistrin Tregtar i Vendimit Nr.1, datë 29.01.2007 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të shoqërisë Bashkimi Shpk, të Kontratës së Shitjes së Kuotave Nr.422Rep., 147 Kol., datë 29.01.2007 dhe Vendimit Nr.2, datë 30.01.2007 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë Bashkimi Shpk

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.7632, datë 04.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" me ndryshimet përkatëse, Ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", Ligji Nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare"

Unë kërkuesja, Miranda SINAJ e bija e Lavdoshit dhe Dritës, e datëlindjes 23.06.1970, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Naim Frashëri", Pall.47/2, e identifikuar me pasaportën nr. Z.0597571, me cilësinë e Administratorit të shoqërisë **BASHKIMI SH.P.K.**, Ju drejtohem me këtë kërkesë për depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit Nr.1, datë 29.01.2007 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të shoqërisë Bashkimi Shpk, të Kontratës së Shitjes së Kuotave Nr.422Rep., 147 Kol., datë 29.01.2007 dhe Vendimit Nr.2, datë 30.01.2007 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë Bashkimi Shpk.

Me Vendimin Nr.1, datë 29.01.2007, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të shoqërisë Bashkimi sh.p.k. ka vendosur të miratojë në parim shitjen e 50% të kuotave që Z.Veledin BRAHIMI zotëronte në shoqërinë Bashkimi shpk me vleftën 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë te Z.Vulnet SINAJ.
Me Kontratën e Shitjes së Kuotave **Nr.**422Rep., 147 Kol., datë 29.01.2007, Z.Veledin BRAHIMI i shet Z.Vullnet SINAJ kuotat që zotëron në shoqërinë Bashkimi sh.p.k., të cilat përbëjnë 50% të kapitalit themeltar të kësaj të fundit. Këto kuota shiten me vleftën 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë. Z.Vullnet SINAJ me blerjen e këtyre kuotave shndërrohet në Ortak të shoqërisë Bashkimi sh.p.k., duke u bërë zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave të kësaj të fundit.
Me Vendimin Nr.2, datë 30.01.2007 Asambleja e Ortakëve të Bashkimi shpk ka vendosur të pranojë dorëheqjen e Z.Veledin BRAHIMI nga detyra e Administratorit të shoqërisë dhe të emërojë në këtë detyrë Znj.Miranda SINAJ.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, kërkoj nga kjo gjykatë depozitimin në Regjistrin Tregtar të **Vendimit Nr.1, datë 29.01.2007 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të shoqërisë Bashkimi Shpk, të Kontratës së Shitjes së Kuotave Nr.**422Rep., 147 Kol., datë 29.01.2007 dhe Vendimit **Nr.2, datë 30.01.2007 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë Bashkimi Shpk.**

Bashkëlidhur keni edhe njëkopje të akteve të lartpërmendura.

**Tiranë, më 30.01.2007**

**KËRKUES**

**Miranda SINAJ**

Miranda Sinaj

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**NOTERIA TIRANË**
**Nr. 453 Rep.**
**Nr. 161 Kol.**

PULLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

# VËRTETIM

Sot më 30.01.2007(dymije e shtatë), në Tiranë, para meje noterit Julian ZHELEGU, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit Administratori i shoqërisë "BASHKIMI" Sh.p.k.:
Miranda SINAJ e bija e Lavdoshit dhe Dritës, e datëlindjes 23.06.1970, lindur në Vlorë dhe me banim në Tiranë në adresën Rruga "Naim Frashëri", Pall.47/2, e identifikuar me pasaportën nr. Z.0597571.

Administratori i shoqërisë është shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, e cila më deklaroi se jashtë kësaj zyre dhe me vullnetin e saj të lirë ka formuluar këtë KËRKESË drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilën ia lexoj dhe ajo e nënshkruan atë rregullisht para meje.

Unë, noteri, konform ligjit e vërtetoj atë.

**NOTER**

**JULIAN ZHELEGU**

PULLE TAKSE 50 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE Nr.2 M M[illegible] NOTER TIRANE

REPU[illegible]

[illegible]

Nr. 45 Rep.

V [illegible]

Vertetohet se sot ne date 05.[illegible] para meje noterit u [illegible]-[illegible]it z. Veledin [illegible] i cili depozitoi shumen 100.000 leke per krijimin e [illegible] "[illegible]" sh.p.k. dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

/ [illegible] /

## KERKESE

**KERKUES:** Veledin Brahimi I biri I Adilit dhe I Sherifes, datl.1972, banues ne Vlore, Lagjia "10 Korriku", Nr.140.

**OBJEKTI:** Regjistrimi si person juridik I shoqerise "**BASHKIMI**" sh.p.k.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr.7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992.

27-350

### GJYKATES SE RRETHIT
### TIRANE

Une kerkuesi **Veledin Brahimi** kerkoj regjistrimin si person juridik te shoqerise "**BASHKIMI**" sh.p.k. me dy ortake z. **Veledin Brahimi**, znj. **Miranda Sinaj,** me seli ne Tirane, Rr. "Barrikadave", me kapital fillestar 100.000 leke me kuota **50% z. Veledin Brahimi** dhe **50% znj. Miranda Sinaj** me administratore z. **Veledin Brahimi**, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me objekt te veprimtarise ne fushen e :

Import-eksport, tregetimin e artikujve te ndryshem te gjitha llojeve, tregetimit me shumice e pakice te mallrave te ndyshme elektro-shtepiake, ushqimore, industriale, pije, konfeksione, fruta-perime, materiale ndertimi, prodhime bujqesore e blegtorale,orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike dhe elektronike, hidro-sanitare, hidraulike, kinkaleri, kanceleri zyre e shkolle.Tregetim bimesh medicinale, eterovajore, pleherash e prodhimesh kimike, prodhimesh kozmetike dhe estetike, tregetim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi pjese kembimi per auto, bateri, goma, tregetim makinerish te ndryshme e paisje industriale e bujqesore dhe venjen e tyre ne shfrytezim, tregetim pllakash, plehrash e prodhimesh kimike. Ne fushen e turizmit hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative, punime druri, tregetime prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare dhe auto-servis makinash. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda e jashte vendit

**KERKUES**
**/Veledin Brahimi /**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERIA E TIRANES**
**Nr. 1100 Rep.**
**Nr. — Kol.**

**Tirane me 05/03/2002**

## VERTETIM

Sot ne date 05/03/2002 u paraqit para meje kerkuesi **Veledin Brahimi** madhor, me zotesi juridike per te vepruar, i pa njohur prej meje, per identitetin e te cilit u njoha nga pasaporta Nr.1032309, i cili deklaroi se se me siper eshte hartuar me vullnetin e tij te lire dhe firmos pa verejtje ne pranine time dhe une notere e vertetoj sipas ligjit

**NOTER**
**/ Nezir Marati /**